



DEKLARATË

Bazuar në Programin Politik, si parti e qendrës së djathtë e cila synon integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian.

Duke u nisur nga synimet për respektim të lirisë, drejtësisë, përgjegjësisë, transparencës dhe të shprehurit e lirë.

Lidhja Demokratike e Kosovës deklaron se është e përkushtuar që zgjedhjet lokale, të cilat do të mbahen me 22 tetor 2017, të zhvillohen në frymë demokratike duke respektuar plotësisht Kushtetutën, standardet evropiane dhe parimet themelore të përcaktuara me ligj.

Ne zotohemi për një fushatë korrekte dhe të qytetëruar, në të cilën do të reflektohet toleranca, sjellja demokratike dhe respekti i ndërsjellë.

LDK-ja angazhohet që rezultati i zgjedhjeve të burojë nga vullneti i shprehur me votën e lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe konfirmon respektimin e kësaj vote.

Prishtinë, 22 gusht 2017

Isa Mustafa
Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës